



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORTI VJETOR
I
INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
VITI 2017

[Shqiptaria.com]

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
1. KUADRI LIGJOR DHE REFORMA NË DREJTËSI	5
1.1. Zbatimi i Ligjit nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.....	5
1.2. Zbatimi i Ligjit nr.60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.....	10
1.3 Zbatimi i Ligjit nr. 9049/2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa Nëpunësve Publikë” dhe Sistemi Elektronik i Deklarimit të Interesave privatë.....	16
2. TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË	19
2.1. Administrimi i deklaratave.....	19
2.2. Skanimi, përpunimi paraprak dhe kontrolli aritmetik dhe logjik.....	20
2.3. Kontrolli i Plotë.....	20
2.4. Rezultatet e kontrollit.....	21
3. ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES	23
4. BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR	24
4.1. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i brendshëm.....	24
4.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	25
5. REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHTETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT	26
6. TRANSPARENCA INSTITUCIONALE	28
7. PERFORMANCA FINANCIARE	29
8. PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE	31
9. PRIORITET PËR VITIN 2018	32
ANEKSI NR.1	34

□ □ □ □ □

Raporti Vjor i Inspektorit të Përgjithshëm, të Inspektoratit të Lartë të Diklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konjunktive të Interesave, paraqitë në përmbushje të detyrimit ligjor parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. N1/N dat. / . - I - D . G “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i nënryshuar.

Inspektorati i Lartë i Diklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konjunktive të Interesave, për më së miri në këtë raport, bën të njohur punën dhe aktivitetin institucional; problematikën më të cilën është në shprehje gjatë vitit raportues për zbatimin e kuarit të ligjor, të rezultateve të arritura, masat konkrete të marrë në kështjellim dhe luftës kundër korrupsionit dhe tërcimit të shtetit ligjor, bashkëpunimin ndër-institucional, bashkëpunimin dhe transparencën realizuar më më të mirë, shoqërimin civil, organizmat e kombëtarë dhe institucionet homolo .

Inspektorati i Lartë i Diklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konjunktive të Interesave (Inspektorati i Lartë), gjatë vitit raportues, duket vlerësuar në sistemin e procedurave të sistemit të drejtësisë, si një masë efektive dhe mënyrën për të rikthyer besimin publikut të institucionit të kështjellit, si dhe për të arantuar konsolidimin dhe kështjellimin e shtetit të drejtësisë, nën kushtet e kështjellit të procesit për më të mirë kapacitetin e tij institucional, mënyrën përmbushje të detyrimeve funksionale në mënyrë samë-katëmbër në aftësitë parashikuara në Kushtetut të Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në qitë lidhura me procesin e rivlerësimit kalimtar të vlerësuar dhe prokurorëve .

Në këtë kuarë, Inspektorati i Lartë mori të vjetha masat në veshmë për të arantuar një proces samë-katëmbër dhe të sigurt të plotësimit, dorëzimit të klaratave të pasurisë në subjektin e rivlerësimit, vëntimin e aftësitë të dorëzimit, llojin e kokumentit të justifikues dhe shoqërimin në veshmë për çështjet e interesave pasurorë të klaruar për lëshim të burimit të krijimit të pasurive .

Në për më të mirë kështjellim, Inspektorati i Lartë lloi procesin e rivlerësimit të vjetha të dhe në vënt paraqitura në klaratave të pasurisë në subjektin e rivlerësimit mbi ligjëshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së klaruar, si dhe situatave të mundshme të konjunktive të interesave në për më të mirë marrësi në informacionit të veshmë të kështjellit në arëgjistrat publikë privatë dhe kontrollin më të mirë natë paraqitura të klaruara në vënt subjektin .

Gjithashtu, në kushtet e vëntë vëntë kështjellim për më të mirë ka qënë nën kushtet marrëdhënieve institucionale të bashkëpunimit me inspektoratit të Lartë mënyrën e rivlerësimit, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit të Kombëtar të Monitorimit, duket synuar llojtësimin e procedurave të koordinimit të punës së bashkëpunimit për dorëzimin e raportit për nëntar, së bashkë me detyrën për subjektin e rivlerësimit sipas kështjellit të paraqitura në kështjellit të rakorduarit Inspektoratin të Lartë në zbatimin e kuarit ligjor.

Në të njëjtë kohë, Inspektorati i Lartë vazhdoi me të zbatimin mënyrën korrekte të tërë ligjeve bazë së katëmbër të ligjit nr. a . dat . ç . - I - D . G “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i nënryshuar, ligjit nr. NGKM

NDKMG-D. I c "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", k
k Nj g b K l e j k N P K c . H k Y . K K . D . ç K c "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve".

G Ç O Ç b K N O , k ç g j P . h y K h k K D K Y C k / P . K s . H k N P k s . h ° . H k O i K e b y i P k N P k s . S . h H k O k
ç H P P g k i P k N e b y k P k P V Y . K M O k g n l b M . K P b K O i h H D . ç M ç Y K e K e r K K . h P g k G . O j Y C k
K O N P K b K k C i . s . k l O k Y K . y h k i P h y k l O k Y y h P i P k N e P k y . y H P i P . k N O g j y . k l O k Y h P . g j C k
K a k j e s . k O k G . L b g g P . P i g R N k i P k O K O K N e P . k O N P h . H O k G . L b g g P g i O N P i j y . P i P k
. b g g i P h b P g P k . b . y P k N e b y k P k y . M g j k P k i P . O j . H k K s . H k K O b j H K O P K y . b y ° Y P k
V y M . H k O k U P g g O k l O k ° . H k g n l b M . K k O k . h ° . k P k N P . K s . H k O k H P P g k i P k y i K O k
K K N K . k P k . S . h H k O k h P P g j h g j k N P k e P h . k P k e g P i P k O g j . K . j . H P k a K K h . k P k
s . L ° h P g g O g j K j b P g P k



1.KUADRI LIGJOR DHE REFORMA NË DREJTËSI

1.1.ZBATIMI I LIGJIT NR. 84/2016 “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Inspektorati i Lartë), përgjatë vitit raportues ka qenë tërësisht i angazhuar me pjesën më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale në zbatimin e procesit të reformimit të sistemit gjyqësor në Shqipëri, i cili përfshin rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve/ ndihmësve ligjorë të të gjitha niveleve (Vetting).

Reformimi i sistemit të drejtësisë, si një proces mjaft i rëndësishëm për Shqipërinë, që synon të luftojë elementët e korruptuar në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të rikthyer besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi, si dhe për të garantuar konsolidimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, njërin nga komponentët kryesorë të tij e lidh me vlerësimin e pasurisë, proces ky, i cili është ngarkuar për t’u kryer nga ILDKPKI.

Kështu, me ligjin nr. 84/2016, datë 22.7.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nën pjesën 8417, Art. 21.10.1998”. Ligji nr. 84/2016, datë 22.7.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nën pjesën “Aneks”, “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Neni D “Vlerësimi i pasurisë”, u parashikua se:

- Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim, pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur me ta.
- Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme, përcaktohen me ligj.
- Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.
- Subjekti i rivlerësimit, dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin.
- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit.
- Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Në vijim, me miratimin e ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në kushtet kur procesi i rivlerësimit kryhet në tre komponentë, lidhur me komponentin e parë “Vlerësimi i pasurisë” u parashikua se:

- Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.
- Të gjithë subjektet e rivlerësimit duhet të plotësojnë deklaratën e pasurisë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.
- Subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.
- ILDKPKI, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- Në përfundim të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, ku konstaton se:
 - a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti i interesit;
 - b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) është kryer fshehje e pasurisë;
 - ç) është kryer deklarim i rremë;
 - d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” u përfshi dhe formulari i ri i Deklarimit të Pasurisë, për t’u plotësuar nga subjektet në proces rivlerësimi.

Për sa më sipër, ILDKPKI në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, mori të gjitha masat e nevojshme organizative për të hartuar dhe miratuar aktet nënligjore në ndihmë të procesit të plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës së pasurisë, bashkëlidhur si shtojca 2 e ligjit nr. 84, datë 30.8.2016, si dhe marrjen e të gjitha masave institucionale për të lehtësuar procesin e mbledhjes, administrimit, regjistrimit dhe ruajtjes së deklaratave të dorëzuara nga subjektet rivlerësuese.

Kështu, me anë të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u përcaktuan rregullat për mënyrën e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës pranë Inspektoratit, evidentimi i dorëzimit, afatet e dorëzimit, lloji i dokumenteve justifikuese për çdo interes pasuror të

deklaruar e për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, si dhe dokumentet shoqëruese të nevojshme.

Ndonëse, Inspektorati i Lartë garanoi të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të filluar, mbarëvajtur dhe përfunduar procesin e mbledhjes e kontrollit të deklaratave të pasurive për subjektet që shfaqën interes për të qenë pjesë e procesit të rivlerësimit, ky proces u pezullua me anë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese datë 25.10.2016.

ILDKPKI, me pushimin e efektit pezullues të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke filluar nga muaji janar 2017, vijoi procesin e pritjes së deklaratave të pasurive, duke marrë të gjitha masat për regjistrimin dhe pasqyrimin me anë të inventarëve të detajuar jo vetëm të deklaratës së pasurisë, por të të gjithë dokumentacionit shoqërues të dorëzuar nga subjektet e rivlerësimit, për të siguruar pajisjen e çdo subjekti me vërtetimin përkatës të dorëzimit pranë institucionit.

ILDKPKI, në përfundim të këtij procesi evidentoi se numri i subjekteve që paraqitën deklaratën e pasurisë brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 31, pika 1 e Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është në total 794 subjekte të procesit të rivlerësimit. Të kategorizuar sipas institucionit dhe funksionit rezulton se:

- 7 janë Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe 9 janë Këshilltarë Ligjorë pranë kësaj gjykate;
- 15 janë Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe 20 janë Ndhimësa Ligjorë pranë kësaj gjykate;
- 373 janë Gjyqtarë të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit dhe 27 janë Ndhimësa Ligjorë pranë gjykatave administrative;
- 326 janë Prokurorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë për Krimet e Rënda, prokurorive të rretheve gjyqësore dhe apelit dhe 7 janë Ndhimësa Ligjorë;
- 10 janë Kryeinspektori dhe Inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Nuk dorëzuan brenda afatit ligjor, të parashikuar nga neni 31, pika 1 e Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë ILDKPKI deklaratën e pasurisë në total 6 subjekte të procesit të rivlerësimit, nga të cilët 3 janë Gjyqtarë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, 1 është Gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë dhe 2 janë Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

ILDKPKI, për të gjithë subjektet e përfshirë në këtë proces, mori masa për përpilimin e dosjeve fizike individuale, në të cilat u përfshinë në mënyrë sistematike dhe të plotë fillimisht deklaratat e pasurisë, dokumentet justifikues dhe në vijim e gjithë korrespondenca lidhur me procesin e rivlerësimit. I gjithë dokumentacioni i administruar në dosje reflektohet në çdo rast në inventarin e dosjes.

Inspektorati i Lartë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për realizimin e kontrollit të plotë të deklaratave të pasurisë lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë, dërgoi korrespondencën shkresore për marrjen e informacionit për më shumë se **3.000 persona** (subjekte të rivlerësimit dhe persona të lidhur).

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë me qëllim saktësimin dhe rakordimin e të dhënave, mori masa për të nxjerrë dhe përpunuar në mënyrë manuale nga deklarata e pasurisë së dorëzuar në kuadër të rivlerësimit, së bashku me deklaratat e dorëzuara nga subjektet ndër vite, të të dhënave të detajuara (atësi, mëmësi, datëlindje, numër identifikues, status civil, etj.) për më shumë se **3.000 persona** (subjekte të rivlerësimit dhe persona të lidhur).

Korrespondenca shkresore ju dërgua fillimisht rreth 26 institucioneve juridikë publikë dhe privatë, (Banka e Shqipërisë, banka të nivelit të dytë, shoqëri investimesh, ZQRPP, QKB, ALUIZNI, DPT, DPPPP, Drejtoria e Përgjithshme Detare, OSSHE, etj). Gjatë procesit të kontrollit, në varësi të ecurisë së tij, si dhe nevojës për të marrë informacione shtesë, ILDKPKI vijoi me dërgimin e mëtejshëm të korrespondencës shkresore pranë institucioneve juridikë publikë dhe privatë.

Kthimi i përgjigjeve të ardhura nga kjo korrespondencë, përfshirë dhe dokumentacionin e dorëzuar nga vetë subjektet e rivlerësimit, arrin në një volum të konsiderueshëm me rreth 1 milion e 200 mijë faqe për t'u administruar, vlerësuar, përpunuar dhe pasqyruar nëpër aktet e kontrollit. Kompleksiteti i këtij procesi shtohet jo vetëm nga volumi i madh i informacionit të marrë dhe nevojës për vlerësim e përpunim nga ILDKPKI, por mbi të gjitha nga administrimi i tij në mënyrë tërësisht manuale nga të gjitha palët e përfshira në këtë proces.

Inspektorati i Lartë, në përmbushje të detyrimeve ligjore, për kryerjen e procesit të kontrollit të subjekteve të rivlerësimit, hartoi listën e subjekteve prioritare, në të cilën u përfshinë funksionarët më të lartë të sistemit të drejtësisë, duke filluar nga Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kandidatët nga radhët e gjyqësorit/prokurorisë për KLGJ dhe KLP, për të cilët raportet e vlerësimit do të përfundonin dhe do të përcilleshin për vlerësim të mëtejshëm me përparësi pranë organeve të rivlerësimit, si dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

Në këto kushte, ILDKPKI me konstituimin dhe fillimin e funksionimit të organeve të vettingut (Komisionit të Pavarur të Kualifikimit), si dhe ONM në fund të muajit tetor 2017 kishte përfunduar procesin e kontrollit të subjekteve të përfshira në listën prioritare, duke dërguar pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës nëntor - dhjetor 2017, dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara sipas konkluzioneve të kërkuara nga neni 33 i Ligjit nr. 84/2016, për **67 subjekte të procesit të rivlerësimit**. Në listën e këtyre subjekteve u përfshinë krerët më të lartë të sistemit të drejtësisë, duke filluar që nga Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, e në vijim me Kryetarin dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë, si dhe Prokurorin e Përgjithshëm, prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe kandidatët nga radhët e gjyqësorit/prokurorisë për KLGJ dhe KLP.

Inspektorati i Lartë, për të garantuar një ecuri sa më të mirë të të gjithë procesit të rivlerësimit, vendosi komunikimin/marrëdhëniet institucionale me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) që në fillim të muajit gusht 2017 me organizimin e takimeve koordinuese me vëzhguesit ndërkombëtarë dhe stafin e tyre mbështetës.

Në vijim të këtyre takimeve dhe kërkesave të parashtruara nga ONM, mbi mundësimin e aksesit të plotë për vëzhguesit ndërkombëtarë, kërkimin e informacioneve, konsultimin, kopjimin dhe hetimin e deklarimeve të pasurive të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur me të, si dhe dokumentet shoqëruese, ILDKPKI u angazhua me burimet e saj njerëzore dhe institucionale për të krijuar kopje elektronike (skanim) të të gjitha materialeve të përfshira në dosjet individuale fizike të subjekteve të rivlerësimit.

Pavarësisht volumit të dosjeve fizike për çdo subjekt rivlerësimi, ku dosja më e thjeshtë arrin përafërsisht 1000 faqe, ILDKPKI ka përfunduar skanimin e të gjithë dokumenteve, të cilat duke qenë të evidentuara në formë shkresore dhe elektronike kanë rritur më tej garancinë ndaj çdo dëmtimi apo tjetërsimi të të dhënave të përfshira në to. Aktualisht, dosja e çdo subjekti rivlerësimi krahas formatit shkresor (dosja fizike), kopjohet në format elektronik (skanim), duke u ruajtur në serverat e institucionit, përkundrejt dosjes origjinale dhe kopjes elektronike të saj që dërgohet pranë KPK dhe ONM.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë mbi kërkesën e paraqitur nga ONM vendosi në dispozicion të vëzhguesve ndërkombëtarë listën me të dhënat e detajuara (atësi, datëlindje, numër identifikues, status civil etj) të nxjerra dhe të përpunuara në mënyrë manuale nga deklaratat e pasurisë së dorëzuar në kuadër të rivlerësimit, së bashku me deklaratat e dorëzuara nga subjektet ndër vite, për më shumë se **3.000 persona** (subjekte të rivlerësimit dhe persona të lidhur).

Inspektorati i Lartë shpreh angazhimin maksimal për të vijuar mbështetjen e procesit edhe përgjatë vitit 2018, në përmbushjen e detyrimeve të tij kushtetuese e ligjore në dorëzimin e raporteve përfundimtare, së bashku me dosjet respektive të subjekteve të rivlerësimit pranë organeve të rivlerësimit dhe ONM, sipas kërkesave periodike të paraqitura nga këto organe dhe të rakorduara me Inspektoratin e Lartë.

1.2.ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Inspektorati i Lartë), përgjatë vitit raportues vijoi përmbushjen e kompetencave të reja të dhëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me anë të ligjit nr. 60, datë 2.6.2016 “*Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve*”.

Në mekanizmat e raportimit, ligji parashikon ngritjen e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të raportimit në sektorin publik dhe atë privat, të ngarkuar me mbrojtjen e sinjalizuesve nga pasoja të rrjedhura nga sinjalizimi, duke synuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e sinjalizuesit nga hakmarrja, me anë të krijimit të një strukture pranë Inspektoratit të Lartë me kompetenca hetimore të çështjeve, si në sektorin publik dhe atë privat.

Në kuadër të këtij ligji, sinjalizues mund të jetë çdo individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat,

pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

Në zbatim të ligjit, ILDKPKI, përveç funksionimit si mekanizëm i jashtëm raportimi, ngarkohet: të monitorojë dhe të nxjerrë udhëzime për mekanizmat e sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm; të kontrollojë funksionimin e duhur të mekanizmit të sinjalizimit të brendshëm të njësive përgjegjëse të organizatave; të konstatojë kundravajtjet administrative sipas këtij ligji, dhe të vendosë gjopa në përputhje me nenin 23 të këtij ligji; të marrë dhe të hetojë kërkesat për mbrojtje ndaj masave hakmarrëse kundër sinjalizuesve dhe të garantojë mbrojtjen e sinjalizuesit nga masat hakmarrëse; mbi bazën e raporteve vjetore të njësive përgjegjëse, të hartojë vlerësime dhe të japë rekomandime për zbatimin e këtij ligji; të ofrojë këshillim dhe mbështetje në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve; të ndërgjegjësojë publikun për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, si dhe të rrisë pranimin kulturor të sinjalizimit.

Gjithashtu, ligji parashikon një sërë kundravajtjesh dhe masash administrative për shkelje të dispozitave të tij si; mosçaktimi i njësisë përgjegjëse nga organizata, marrja e çdo veprimi hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit; shkelja e parimeve të hetimit të sinjalizimit nga punonjësi; shkelja e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit; mosfillimi i hetimit ose përfundimi i hetimit administrativ nga punonjësi, duke parashikuar aplikimin e sanksioneve me gjobë, të cilat variojnë nga 100.000 deri në 500.000 lekë.

ILDKPKI, në përmbushje të detyrimeve ligjore, të përcaktuara në këtë ligj, mori të gjitha masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, me qëllim plotësimin e kuadrit të nevojshëm për zbatimin sa më efektiv në praktikë të ligjit nga institucionet publike dhe private.

Kështu, Inspektorati i Lartë, në bashkëpunim edhe me partnerët vendas e të huaj, hartoi dhe miratoi aktet nënligjore si vijon:

- ✓ Udhëzim i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 1, datë 23.9.2016 “*Për miratimin/përcaktimin e strukturës, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit e punonjësve të njësisë përgjegjëse në subjektet private*”.
- ✓ Rregullore “*Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në ILDKPKI*”.
- ✓ Rregullore “*Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në ILDKPKI*”.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë kontribuoi në hartimin dhe miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 16.11.2016 “*Për Strukturën, Kriteret e Përzgjedhjes dhe Marrëdhëniet e Punës së Punonjësve të Njësisë Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve*”.

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit raportues, në vijim të Projektit “*Zbatimi i legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, të implementuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë përfundoi procesin e hartimit të dokumenteve ndihmëse, të tilla si formulari i raportimit të brendshëm dhe të jashtëm, formulari i kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja, formati i regjistrave të sinjalizimit, që do të mbahen nga njësitet përgjegjëse, udhëzimi mbi formatin e

rregullores së brendshme që do të hartohet dhe miratohet nga njësitë përgjegjëse. Këto dokumenta janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, lehtësisht të aksesueshme nga çdo subjekt i interesuar.

Në lidhje me njësitë përgjegjëse, ILDKPKI, me hyrjen në fuqi të dispozitave të këtij ligji, nga data 1 tetor 2016, mori të gjitha masat e nevojshme fillimisht për identifikimin e autoriteteve publike, duke rakorduar punën me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Departamentin e Administratës Publike, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të evidentuar autoritetet publike, të cilat kishin të punësuar mbi 80 punonjës, kufi ky i parashikuar në ligj për caktimin e njësisë përgjegjëse pranë organizatës.

Në vijim, ILDKPKI vendosi kontaktet përkatëse për ngritjen e njësive përgjegjëse dhe raportimin e tyre pranë Inspektoratit të Lartë. Me mbledhjen e informacionit të dërguar nga autoritetet publike, ILDKPKI përfundoi procesin e hartimit të Regjistrisë Kombëtare të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Nga të dhënat statistikore rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë **163 njësi përgjegjëse** në sektorin publik.

Ndërsa, duke filluar nga 1 korrik 2017, me fillimin e efekteve ligjore për sektorin privat, ILDKPKI koordinoi punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të identifikuar në sektorin privat organizatat të cilat kishin të punësuar mbi 100 punonjës, për të vendosur kontaktet përkatëse për ngritjen e njësive përgjegjëse dhe raportimin e tyre pranë Inspektoratit.

Me mbledhjen e informacionit të dërguar nga institucionet private, ILDKPKI përfundoi procesin e hartimit të Regjistrisë Kombëtare të Njësive Përgjegjëse në Sektorin Privat, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë **446 njësi përgjegjëse** në sektorin privat.

Në përfundim të procesit të raportimit të ngritjes së njësive përgjegjëse nga organizatat, ILDKPKI për organizatat të cilat mbartnin detyrimin për ngritjen dhe raportimin e njësive përgjegjëse, por që nuk e përmbushën këtë detyrim brenda afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 60/2016, vendosi masa administrative me gjobë **për rreth 140 drejtues organizatash**.

Në të njëjtën kohë, ILDKPKI punoi dhe po vazhdon të punojë në drejtim të rritjes së kapaciteteve, ndërgjegjësimin dhe asistimin e institucioneve në zbatimin e kuadrit ligjor, ku në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e saj ndërkombëtarë dhe Shkollën e Administratës Publike (ASPA) përfundoi kurrikulën e Trajnimit të Trajnerëve, në bazë të të cilës u organizua një trajnim për të gjithë trajnerët e ASPA-s, të përfshirë në kurrikulat kundër korrupsionit. Këta trajnerë u angazhuan gjatë muajit korrik 2017 në zhvillimin e seminareve trajnuese dy ditore për autoritetet përgjegjëse në nivel qendror, në total për 32 njësi përgjegjëse. Për më tepër, ILDKPKI gjatë kësaj periudhe organizoi dhe zhvilloi dy seminare trajnuese për të gjithë 28 inspektorët e saj mbi njohjen dhe zbatimin në praktikë të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Në përmbushje të rolit të tij ndërgjegjësues, Inspektorati i Lartë, në kuadër të Projektit “Zbatimi

i legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, gjatë vitit raportues organizoi një fushatë ndërgjegjëse, të ndarë në dy faza, ku në fazën e parë përfshiu:

- ✓ Përgatitjen dhe transmetimin e spotit televiziv publicitar “TV Spot 1”, informues mbi ligjin, fushën e zbatimit, institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij, sanksionet në rast mospërbushje të detyrimeve ligjore, si dhe përparësitë e ligjit në luftën kundër korrupsionit. Spoti u transmetua për një periudhë një mujore në disa TV kombëtare dhe rajonale si dhe në median online.
- ✓ Përgatitjen dhe printimin e posterave, në të njëjtën kohë me transmetimin e spotit publicitar, si dhe vendosjen e tyre në pikat kryesore të qytetit.
- ✓ Video të transmetuara në platformat online, youtube dhe media sociale.

Ndërsa faza e dytë përfshiu përgatitjen dhe transmetimin e “TV Spot 2”, në të cilin u ofrua informacion për punonjësit e institucioneve dhe publikun në përgjithësi mbi procedurat, format konkrete të sinjalizimit në institucione, çfarë duhet bërë në raste të tilla etj.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve institucionale, në muajin qershor 2017, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë, u organizua një Vizitë Studimore në Hollandë për 8 inspektorë të ILDKPKI, me fokus kryesor organizimin dhe zhvillimin e disa takimeve pune me institucionet shtetërore dhe organizatat private lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e trajtimit dhe hetimit të rasteve të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2017, ka përcjellë pranë njësive përgjegjëse të autoriteteve publike “Udhërrëfyes për Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit në Shqipëri”, dokument i hartuar në kuadër të iniciativës së organizatës “Koalicioni i Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, e mbështetur nga National Endowment for Democracy, i konceptuar si një përmbledhje pyetjesh dhe përgjigjesh, të cilat mund të lindin përpara, gjatë apo mbas sinjalizimit, duke i ofruar mundësinë punonjësve dhe njësive përgjegjëse për të njohur më mirë mekanizmat që parashikon Ligji nr. 60/2016, për sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, si dhe për përdorimin e tyre në mënyrë sa më efektive.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me njësitë përgjegjëse, Inspektorati i Lartë iu ka rikujtuar përmbushjen e detyrimeve ligjore parashikuar nga nenet 13 dhe 22, të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” lidhur me miratimin e rregulloreve të brendshme, si dhe paraqitjes pranë ILDKPKI të raportit vjetor me shkrim brenda datës 15 janar 2018.

Inspektorati i Lartë ka marrë dhe ka administruar 161 raporte vjetore nga njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike, ku nga analizimi i tyre konstatohet se në 7 njësi përgjegjëse janë sinjalizuar dhe trajtuar raste në kuadër të ligjit nr. 60/2016, si më poshtë vijon:

- 1- **Shërbimi Kombëtar i Punësimit**, në të cilin janë paraqitur dhe janë regjistruar 2 raste sinjalizimi.
- 2- **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**, në të cilin është paraqitur pranë njësisë përgjegjëse 1 rast sinjalizimi,
- 3- **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, në të cilin është regjistruar 1 rast sinjalizimi, si kërkesë ankimore nga Ministria e Drejtësisë, ku në vlerësimin e kërkesave ligjore të parashikuara nga pika 1 e nenit 7 të ligjit nr. 60/2016 dhe pas verifikimit të të dhënave

të sinjalizuesit në sistemin online të Regjistrimit të Shtetasve, duke qenë se rezultoi se nuk ekziston asnjë shtetas me gjeneralitet e sinjalizuesit, njësia përgjegjëse referuar parashikimeve të gërmës a, pika 1, nenit 14 të ligjit nr. 60/2016, vendosi mosfillimin e procedurës së hetimit administrativ.

- 4- **Bashkia Tiranë**, në të cilin është regjistruar 1 rast sinjalizimi.
- 5- **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial** ka raportuar 2 raste sinjalizimi.
- 6- **Bashkia Mat** ka raportuar për auditime të brendshme të kryera në bazë të një plani për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve mbi bazë risku. Për të gjitha problemet e konstatuara janë mbajtur akt verifikime dhe proces verbale, të cilat i janë bërë të njohura subjektit dhe Kryetarit të Bashkisë me Raport auditimi paraprak dhe përfundimtar.
- 7- **Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor** është regjistruar 1 rast sinjalizimi i jashtëm ku pas vlerësimit të bërë nga njësia përgjegjëse është dërguar informacioni përkatës pranë ILDKPKI.

Inspektorati i Lartë gjatë vitit raportues në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, ka regjistruar dhe trajtuar në total 8 raste sinjalizimi dhe 1 rast kërkesë për mbrojtje të ardhur nga sektori publik. Në lidhje me rastet e sinjalizimit, denoncimet kanë qenë si më poshtë vijon:

- A) **4 raste** është pretenduar për shkelje të detyrimeve ligjore për konfliktin e interesit;
- B) **3 raste** është pretenduar për shkelje ligjore në procedurat e tenderimit;
- C) **1 rast** është pretenduar për shkelje në dhënien e vendimeve gjyqësore dhe falsifikim dokumentacioni në proceset gjyqësore.

ILDKPKI ka marrë masa për të regjistruar të gjitha rastet e sinjalizuara në Regjistrin e Sinjalizimeve të Jashtme, si dhe për të zhvilluar hetimin administrativ në respektim të afateve ligjore në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 60/2016 dhe K.Pr. Administrative.

Në përfundim të hetimit administrativ, për zyrtarët e gjetur në shkelje të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, është marrë masa administrative me “gjobë”, si dhe është kërkuar dhe është zgjidhur konflikti i interesit në përputhje me parashikimet ligjore. Kështu, janë aplikuar 3 masa administrative me “gjobë” ndaj zyrtarëve për shkelje të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, si dhe është zgjidhur konflikti i interesit me largimin nga detyra të zyrtarëve që kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

Gjithashtu, ILDKPKI për rastet e tjera të sinjalizuara, pas hetimit administrativ ka vënë në dijeni organin kompetent sipas problematikës së ngritur nga sinjalizuesit, si vijon:

- ↓ -Njoftim pranë KLSH për auditim të fondeve publike;
- ↓ -Njoftim për ndjekje penale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- ↓ -Njoftim Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- ↓ -Njoftim Titullarit të Autoritetit Publik Qendror për marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Në lidhje me kërkesën për mbrojtje nga hakmarrja, Inspektorati i Lartë pas regjistrimit të saj në Regjistrin e Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja të ILDKPKI ka zhvilluar hetimin administrativ në përputhje me afatet ligjore të parashikuara nga dispozitat e Ligjit nr. 60/2016

dhe K.Pr. Administrative. Në përfundim të hetimit administrativ ka rezultuar se nuk kishte ndodhur një akt hakmarrje të marrë nga organizata, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë për sinjalizimin e jashtëm të paraqitur pranë ILDKPKI.

Inspektorati i Lartë në një vlerësim të përgjithshëm mbi zbatimin e Ligjit nr. 60/2016, duke marrë në konsideratë periudhën relativisht të shkurtër gjatë të cilës i ka shtrirë efektet juridike (përreth 1 vit për sektorin publik dhe 6 muaj për sektorin privat), si dhe qëllimin e tij për të trajtuar një fenomen të ri jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin e më gjerë, ku ende nuk ekzistojnë praktika të mirëfillta dhe të konsoliduara, thekson nevojën e një periudhe më të gjatë raportimi mbi këtë ligj në mënyrë që të mund të debatohet mbi zbatueshmërinë apo efikasitetin e tij.

Megjithatë, ILDKPKI shpreh vlerësimin, se ndonëse Shqipëria është ende në hapat e para të saj, përsa i përket zbatimit të ligjit, e parë kjo situatë në kontekstin e procesit të integritetit të Shqipërisë në familjen Evropiane dhe përmbushjes së 5 prioritetëve kyçe, miratimi dhe fillimi i zbatimit të Ligjit nr. 60/2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”* duhet të konsiderohet si një hap shumë i rëndësishëm në këtë drejtim.

ILDKPKI duke besuar se arritja e një niveli të kënaqshëm zbatueshmërie kërkon domosdoshmërisht rritjen e ndërgjegjësimit, jo vetëm të subjekteve të këtij ligji, por edhe të publikut të gjerë, si dhe vijimin e rritjes së kapaciteteve të njësive përgjegjëse, shpreh angazhimin për të vendosur në fokus të veprimtarisë së tij përgjatë vitit pasardhës përmbushjen e këtyre objektivave.

Në këtë kuadër, ILDKPKI me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit *“Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”*, projekt ndërmjet Austrisë, Gjermanisë dhe Shqipërisë, i financuar nga BE, i vlerësuar si një nga projektet më të mëdha mbi politikën kundër korrupsionit, të financuar ndonjëherë nga BE në Shqipëri, ka të programuar sesione trajnuese për autoritetet përgjegjëse pranë institucioneve publike mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit, si dhe organizimin e një fushate ndërgjegjësuese për sektorin privat mbi zbatueshmërinë e ligjit.

Në të njëjtë kohë, ILDKPKI është duke punuar ngushtësisht me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar mbështetje institucionale në përmbushjen e nevojave të identifikuar, lidhur me mbulimin sa më të gjerë të njohjes dhe ndërgjegjësimit nga sektori privat, të kuadrit ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

1.3.ZBATIMI I LIGJIT NR. 9049/2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR DHE SISTEMI ELEKTRONIK I DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Inspektorati i Lartë), me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 42, datë 06.4.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”* mori të gjitha masat ligjore dhe administrative për zbatimin në praktikë të ndryshimeve të kuadrit të tij ligjor.

Ligji nr. 42, datë 06.4.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” ndikoi kryesisht në:

- Reduktimin e numrit dhe disa kategorive të zyrtarëve publikë, që mbartin detyrimin për deklarim, duke synuar që detyrimi për deklarim të kryhet tashmë vetëm nga zyrtarët e nivelit më të lartë drejtues. *(Reduktoi një kategori të ulët të subjekteve deklarues në sistemin e tatimeve, doganave dhe Policinë e Shtetit, si dhe një kategori e mesme në pushtetin vendor, deklaratat e të cilëve përbënin një numër të konsiderueshëm në totalin e deklaratave të administruara dhe kontrolluara nga ILDKPKI).*
- Përfshirjen e kandidatëve në sistemin e drejtësisë në rrethin e subjekteve të cilët mbartin detyrimin për deklarim të interesave privatë, përpara emërimit të tyre në funksion.
- Shkurtimin e intervalit kohor të kryerjes së kontrollit të plotë nga 1 herë në 3 vjet, në 1 herë në 2 vjet për deputetët, si dhe shtimin e subjekteve të tjerë, të cilët emërohen rishtazi me krijimin e institucioneve të reja në vijim të amendamenteve kushtetuese, në kuadër të reformës në drejtësi, që do të kontrollohen në mënyrë të plotë 1 herë në 2 vjet.
- Rregullimin e procedurës së zgjedhjes dhe shkarkimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, si dhe afatin e ushtrimit të mandatit.
- Përcaktimin në mënyrë të qartë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Inspektorit të Përgjithshëm, duke reflektuar këtu edhe kompetencat shtesë të ILDKPKI-së për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
- Ndryshimin e emërtimeve të institucioneve të reja apo të transformuara nga Reforma në Sistemin e Drejtësisë. Të tilla përmenden: anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.
- Parashikimin e konceptit të plotësisimit dhe depozitimit të deklaratave elektronikisht me qëllim modernizimin e sistemit të deklarimit të pasurisë, duke krijuar premisa që në të ardhmen e afërt të krijohet sistemi elektronik ose on-line, i deklarimit të pasurive për të gjithë subjektet deklaruese.
- Forcimin e bashkëpunimit të ILDKPKI-së me autoritetet përgjegjëse në të gjitha institucionet shtetërore, veçanërisht në procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive.
- Harmonizimin më të plotë të ligjit, me Kodin e ri të Procedurave Administrative në kryerjen e procedurave të kontrollit dhe hetimit administrativ, dhe përfundimin e tyre në një kohë të arsyeshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi *(brenda 6 muajve nga fillimi i kontrollit të plotë apo hetimit administrativ).*
- Aksesimin e drejtpërdrejtë të të dhënave, gjatë procesit të kontrollit nga ILDKPKI, nga të gjitha institucionet shtetërore, mbajtëse të tyre.
- Publikimin në faqen e internetit të ILDKPKI të të gjitha deklaratave të interesave privatë, të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim, nëpërmjet sistemit online, duke siguruar një transparencë të plotë për publikun e gjerë, mediat, shoqërinë civile apo personat e tjerë të interesuar.
- Ashpërsimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative deri në 5 - fishimin e tyre.

Në këtë kuadër, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, Inspektori i Përgjithshëm me Urdhërin nr. 223, datë 9.5.2017, miratoi formularët e deklarimit të interesave privatë, në të cilën u pasqyruan ndryshimet ligjore. Ky urdhër u publikua në Fletoren zyrtare nr. 101, datë 9 maj 2017.

Për më tepër, gjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë, në zbatim të nenit 4/2 dhe nenit 34 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, i cili i hapi rrugën mundësisë së plotësimit dhe depozitimit të deklaratave elektronikisht, me qëllim jo vetëm modernizimin e sistemit të deklarimit të pasurisë, por edhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të kryerjes të kontrollit të deklaratave të interesave privatë për subjektet deklarues, me mbështetjen e vyer të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), filloi zbatimin e një projekti dy vjeçar 2017 - 2019, nëpërmjet të cilit do të ofrohet asistencë në përgatitjen dhe ngritjen e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë më datën 3 tetor 2017, nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me University Research Co. (URC), me mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), për ofrimin e asistencës në përgatitjen dhe ngritjen e sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, i cili do t’i mundësojë ILDKPKI rritjen e efikasitetit në plotësimin, administrimin, kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, si dhe publikimin e të dhënave në deklaratat e interesave privatë për konsultim nga publiku, media dhe shoqëria civile apo çdo palë tjetër të interesuar.

Në zbatim të këtij Memorandumi, gjatë periudhës tetor – dhjetor 2017, Inspektorati i Lartë u angazhua në përfundimin e termave të referencës, të nevojshme për zhvillimin e procedurave të prokurimit për pjesën e programimit të sistemit (software), pjesëmarrjen, së bashku me përfaqësues të URC dhe USAID, në komisionin e vlerësimit të ofertave për kompanitë që shfaqën interes për të zhvilluar këtë sistem, si dhe finalizimin e procedurës për përzgjedhjen e kompanisë fituese.

Në të njëjtën kohë, Inspektorati i Lartë vijoi bashkëpunimin e ngushtë me Këshillin e Evropës për zbatimin e projektit “Horizontal Facility” të financuar nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Evropës, ku një nga komponentët e lidhur me sistemin online të deklarimit, sigurimi i pajisjeve (hardware), do të mbështetet nga ky projekt. Për këtë qëllim, më 13 shtator 2017 Këshilli i Evropës dhe ILDKPKI organizoi një Tryezë të Rrumbullakët, në të cilën ishin të ftuar institucionet kryesore vendase dhe partnerët ndërkombëtarë. Gjatë tryezës u parashtrua rëndësia e sistemit online, nevojat e identifikuar për zhvillimin e tij, si dhe u kërkua mbështetja e tyre e mëtejshme institucionale dhe financiare në këtë proces.

Inspektorati i Lartë e vlerëson rëndësinë e kësaj iniciative, jo vetëm si përmbushje të detyrimit ligjor, por edhe si përmbushje të angazhimit të marrë në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015 - 2020 dhe Planit të saj të Veprimit, ku një nga objektivat (Objektivi A5) parashikon specifikisht forcimin e regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave nëpërmjet mundësisit të deklarimeve online të pasurisë për të gjithë subjektet deklaruese, si dhe publikimin e deklaratave të interesave privatë pa kërkesë, si faktorë që kontribuojnë në kufizimin e korrupsionit.

Gjithashtu, ngritja dhe funksionimi i një sistemi elektronik për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë në Shqipëri, ka ardhur si një kërkesë në përmbushje dhe zbatim të detyrimeve të marra nën Prioritetin 3 “Lufta kundër Korrupsionit”, si pjesë e udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe për integrimin evropian të vendit, si dhe në dritën e rekomandimeve të shumta të instrumenteve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë evidentuar nevojën e ngritjes së një sistemi elektronik të deklarimit online për ILDKPKI, si një mekanizëm i nevojshëm në luftën kundër korrupsionit.

Në këtë kuadër, ILDKPKI është e ndërjegjshme që për zbatimin sa më efikas të këtij projekti, sfida vijon të mbetet jo vetëm bashkëpunimi ndërinstitucional për sigurimin e ndërlidhjes apo integritimit me sistemet e tjera publike/regjistrat publikë dhe privatë, me qëllim shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për kryerjen e kontroleve dhe hetimeve administrative të deklaratave të interesave privatë, të cilat aktualisht janë procese që kryhen në mënyrë manuale, por edhe garantimin e një qëndrueshmërie të mtejshme të funksionimit të vetë sistemit.

ILDKPKI për vitin në vijim do të mbetet tërësisht e angazhuar për përmbushjen e detyrimeve të marra përkundrejt ngritjes dhe funksionalizimit të sistemit online të deklarimit të interesave privatë, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, si dhe nëpërmjet sigurimit të mbështetjes nga institucione të tilla si Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, që do të mundësojnë garantimin e qëndrueshmërisë së këtij sistemi.

2. TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË

2.1. Administrimi i deklaratave

Gjatë vitit 2017, Inspektorati i Lartë ka vijuar punën me procesin e pranimit, regjistrimit dhe administrimit të deklaratave të interesave privatë, të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim.

Nga të dhënat e regjistruara dhe të administruara nga Sektori i Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë, rezulton se numri i përgjithshëm i subjekteve (subjekte në funksion, ish-subjekte deklarues dhe persona të lidhur, kandidatë) deri më 31.12.2017 është **14.735 subjekte deklarues**, nga të cilët:

- **23,2 % ose 3.406 subjekte rezultojnë të jenë në funksion**
- **76,7% ose 11.315 subjekte rezultojnë të jenë ish-subjekte deklarues**
- **0,1% ose 14 subjekte rezultojnë të jenë kandidatë**

Numri i deklaratave të administruara nga Inspektorati i Lartë për vitin 2017, është **7.035 deklaratatë të interesave privatë**, nga të cilat, të ndara sipas llojeve të tyre, rezultojnë këto të dhëna statistikore:

- Deklarata Periodike/Vjetore – **4.746 deklaratatë**
- Deklarata Para Fillimit të Detyrës – **697 deklaratatë**
- Deklarata Pas Largimit nga Funksioni – **792 deklaratatë**

rat


ILDI

lara

ter

bër

3)



- De
- De
- De
- U
- D

spe

apor

igj

.4.

jaftue

The first part of the report discusses the current state of the market and the challenges it faces. It highlights the need for a comprehensive strategy to address these challenges and ensure long-term growth.

Executive Summary

The purpose of this report is to provide a detailed analysis of the market trends and opportunities. It aims to identify key areas for investment and development, and to propose actionable recommendations for stakeholders. The findings are based on extensive research and data analysis.

Market Overview

The market is characterized by rapid technological advancements and changing consumer preferences. This has led to increased competition and a need for innovation. The report examines the impact of these factors on the overall market performance.

Key findings include a significant increase in digital adoption across various sectors. This has driven growth in e-commerce and digital marketing. However, it has also led to a shift in traditional business models, requiring companies to adapt quickly.

The report also identifies emerging markets and sectors with high potential for growth. These include artificial intelligence, renewable energy, and space exploration. These areas offer significant opportunities for investment and development.

Recommendations are provided for each of the key areas identified. These include investing in research and development, strengthening digital infrastructure, and fostering partnerships with industry leaders. These actions are essential for staying competitive in a rapidly changing market.


The report concludes by emphasizing the importance of a proactive and collaborative approach. Stakeholders must work together to address the challenges and seize the opportunities presented by the market. This will ensure a sustainable and prosperous future for all.

1. The first step in the process of identifying a problem is to define the problem clearly. This involves identifying the symptoms and the underlying causes of the problem.

2. Once the problem has been defined, the next step is to gather information about the problem. This involves conducting research and consulting with experts in the field.

3. The third step is to generate potential solutions to the problem. This involves brainstorming and evaluating different options. It is important to consider both short-term and long-term solutions.

4. The final step is to implement the chosen solution and monitor its effectiveness. This involves setting up a plan of action and tracking progress over time.



3. ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka qenë gjithnjë i angazhuar në rolin ndërgjegjësues dhe parandalues, në funksion të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”*, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave...”*, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 60/20162016 *“Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”*. Ky rol është ushtruar duke përdorur të gjitha mjetet ligjore e institucionale në dispozicion të institucionit.

Për rrjedhojë, Inspektorati i Lartë, në zbatim të detyrimeve të tij ligjore, në mënyrë periodike, por dhe rast pas rasti në bazë kërkesash, ka ofruar asistencë teknike dhe ligjore për autoritetet përgjegjëse, si strukturat kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit, ku ato ushtrojnë funksionet e tyre.

Duke qenë se autoritetet përgjegjëse janë ato që evidentojnë, administrojnë dhe trajtojnë konfliktin e interesave rast për rast, çdo herë, kur institucionet publike i janë drejtuar zyrtarisht Inspektoratit të Lartë, duke i kërkuar asistencë ligjore për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave, Inspektorati i Lartë është përgjigjur duke organizuar takime të veçanta sqaruese me zyrtarë të niveleve të ndryshme brenda të njëjtit institucion mbi problematikat institucionale apo individuale, të ndeshura.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë në përmbushje të detyrimit ligjor, të parashikuar nga neni 42 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, ka administruar brenda afatit ligjor, raportet e dërguara nga çdo autoritet përgjegjës lidhur me veprimtarinë e kryer prej tyre në zbatim të ligjit, përfshirë edhe rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarimin periodik të interesave privatë.

ILDKPKI, gjatë vitit raportues ka qenë i angazhuar edhe lidhur me rritjen e kapaciteve të njësisve përgjegjëse pranë autoriteteve publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve duke ju dhënë në mënyrë të vazhdueshme asistencë për çështje të parashtruara lidhur me njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor, ofrimin e sesioneve trajnuese, si dhe vënien në dispozicion të *“Udhërrëfyes për Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit në Shqipëri”*, si një iniciativë e Koalicionit të Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, e mbështetur nga National Endowment for Democracy.

4. BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

4.1. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i brendshëm.

Inspektorati i Lartë gjatë vitit raportues ka vijuar bashkëpunimin ndër-institucional me organet ligjzbatuese si një element i domosdoshëm në punën e tij, për të garantuar efektivitet në kontrollet dhe hetimet administrative të kryera, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, me qëllim sigurimin e një hetimi të plotë, të gjithanshëm dhe të mbështetur në prova.

Kështu, në vitin 2017 ka vijuar zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet kryesore në identifikimin dhe luftën kundër korrupsionit, parandalimit të pastrimit të parave dhe krimit të organizuar, konkretisht me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve/Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si mekanizma për lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave.

Gjithashtu, përgjatë vitit raportues Inspektorati i Lartë ka intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit në kuadër të marrjes së informacioneve nga institucionet publike dhe private në kuadër të verifikimit të të dhënave të pasqyruar nga subjektet e përfshira në procesin e rivlerësimit kalimtar (vettingut). Korrespondenca shkresore përfshiu fillimisht përreth 26 institucione publike dhe private, (Banka e Shqipërisë, banka të nivelit të dytë, shoqëri investimesh, ZQRPP, QKB, ALUIZNI, DPT, DPPPP, Drejtoria e Përgjithshme Detare, OSHEE, etj), duke vijuar më tej shtimin e saj në varësi të ecurisë së procesit të kontrollit dhe nevojës për të marrë informacion shtesë.

Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, Inspektorati i Lartë ka vijuar marrëdhëniet ndër-institucionale, jo vetëm me qëllim shkëmbimin e të dhënave, në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore, por dhe për plotësimin e angazhimeve të marra nga institucionet shtetërore në procesin e integritetit në Bashkimin Europian, si Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Ministrinë e Drejtësisë, duke informuar në mënyrë periodike/mujore arritjet dhe sfidat institucionale të ILDKPKI, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të Bashkimit Europian (BE) për Prioritetin 2 “Të sistemit të drejtësisë” dhe Prioritetit 3 “Të luftës kundër korrupsionit”, për aderimin e Shqipërisë në BE.

4.2. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë

ILDKPKI përgjatë vitit raportues ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri, me Agjencitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si OPDAT, USAID, Këshillin e Evropës, zyrën e OSBE-së në Tiranë etj.

Në këtë kuadër, ILDKPKI, gjatë vitit 2017 vijoi procesin e zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”, projekt ndërmjet Austrisë, Gjermanisë dhe Shqipërisë, i financuar nga BE.

Inspektorati i Lartë, si përfitues me tre komponentë kryesorë të tij, lidhur me komponentin për rritjen e kapaciteteve të institucionit, bashkëpunoi me ekspertët e projektit gjatë fazës së hartimit të ndryshimeve ligjore për ligjin nr. 9049/2003, për të marrë asistencën e tyre në përmirësimin e projektligjit. Gjatë vitit në vijim, aktivitetet kryesore në bashkëpunim edhe me

Këshillin e Evropës që do të organizohen për të gjithë nëpunësit në funksion inspektorë pranë ILDKPKI, lidhen me kryerjen e një cikli trajnimesh mbi metodat e kontrollit të pasurive në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të ndryshuara në fuqi, si dhe mbi mënyrat e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave më të mira ekzistuese në rajon mbi deklarimin e pasurive.

Në lidhje me komponentin që ka në fokus ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave, gjatë kësaj periudhe është bashkëpunuar ngushtësisht me ekspertët e binjakëzimit për të hartuar paketën e ndryshimeve ligjore, me qëllim thjeshtëzimin dhe qartësimin e mëtejshëm. Në vitin në vijim, pritet një finalizim i kësaj pakete për të filluar dhe çuar më tej procedurat e nevojshme ligjore për miratimin e tyre nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, Inspektorati i Lartë do të vazhdojë bashkëpunimin për të përmbushur aktivitetet e tjera të përfshira në këtë komponent që synojnë dhënien e:

- a. asistencës për ILDKPKI, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të regjistrit të konfliktit të interesave;
- b. sigurimin e udhëzimeve/manuale për autoritetet përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit të rishikuar të konfliktit të interesave;
- c. sigurimin e materialeve të përditësuara dhe të përmirësuara për trajnimin pranë ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) mbi ligjin e konfliktit të interesave;
- d. cikël trajnimesh për stafin e ILDKPKI-së dhe autoriteteve përgjegjëse, mbi rolet dhe përgjegjësitë respektive për zbatimin e ligjit për konfliktin e interesave, duke përfshirë edhe trajnimet e trajnerëve, të cilët më pas do të japin trajnime pranë ASPA;
- e. cikël trajnimesh/aktivitetesh për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse mbi këshillimin, identifikimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, rast pas rasti;
- f. fushatë ndërgjegjësimi për administratën publike mbi kërkesat/ kriteret e ligjit të konfliktit të interesave dhe akteve të tjera ligjore.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë në vijim të zbatimit të komponentit lidhur me ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, do të ketë në fokus organizimin e trajnimit të autoriteteve përgjegjëse pranë institucioneve publike mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit, si dhe fushatës ndërgjegjësuere për sektorin publik dhe atë privat.

Për më tepër, ILDKPKI gjatë vitit 2017 ka koordinuar procesin e bashkëpunimit midis projekteve të Këshillit të Evropës dhe USAID për ofrimin e asistencës teknike dhe financiare në ngritjen e sistemit online të deklarimit të interesave privatë, si një sistem i cili do të mundësojë mbledhjen në kohë reale të të dhënave/deklarimeve të pasurive dhe burimit të krijimit të tyre nga subjektet e deklarimit; përpunimin e tyre sipas procedurave të brendshme duke evituar kosto në burime njerëzore, financiare dhe kohë efektive; shkëmbimin elektronik të të dhënave me institucione të tjera si QKB, ZRPP, DPT, banka etj.; rritjen e efektivitetit në procesin e kontrollit dhe kryerjen e hetimeve administrative; harmonizimin me sistemet dhe proceset gjysmë elektronike si kontrolli aritmetik dhe logjik dhe regjistri i konfliktit të interesave;

lehtësimin e procesit të ruajtjes fizike të deklaratave; publikimit online të deklaratave të pasurive.

Për sa më sipër, mbështetja operationale e partnerëve ndërkombëtarë apo me ekspertë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, ka qenë e vlefshme dhe e mirëpritur nga Inspektorati i Lartë, ndaj i falenderojmë publikisht për ndihmesën e dhënë.

5. REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHTETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës raportuese ka vijuar aktivitetin institucional duke pasur në fokus edhe rekomandimet e drejtuara Republikës së Shqipërisë nga GRECO, në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë që trajton *“Parandalimin e korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët”*.

Në Raportin për Vlerësimin e Përputhshmërisë për Shqipërinë, të miratuar nga GRECO, për dy nga rekomandimet që kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e ILDKPKI-së, GRECO vlerësoi se:

Rekomandimin iv.) *Bërja publike e përmbajtjes së deklaratave të pasurive të deputetëve në faqen e internetit në kohën e duhur, duke i kushtuar rëndësi privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe të personave të lidhur me ta, që janë objekt i detyrimit për raportim*, ishte plotësuar pjesërisht, duke vlerësuar masat e marra nga Inspektorati në sigurimin e lehtësimit të procedurave të publikimit të deklaratave me anë të heqjes së tarifës administrative dhe kontrollit paraprak të detyruar.

Në vlerësimin e masës si pjesërisht të plotësuar, GRECO rekomandoi autoritetet për krijimin e një mjeti të tillë deklarimi që do të mundësonte vënien në dispozicion të publikut, të deklaratave të 140 deputetëve, në një faqe elektronike zyrtare, pa vonesa të mëtejshme duke i kushtuar vëmendjen e duhur privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe personave të lidhur me ta, që janë subjekt i detyrimit për deklarim.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë propozoi dhe mbështeti ndryshimet në kuadrin ligjor lidhur me mundësinë e një deklarimi online të deklaratave të interesave privatë, si dhe publikimin e tyre nëpërmjet sistemit të ri elektronik, që do të ngrihet për këtë qëllim. Kështu, me anë të ligjit nr. 42, datë 06.04.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”* u parashikuar në nenin 34 pika 2 se *“Deklaratat e interesave privatë janë dokumente zyrtare dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të Inspektoratit të Lartë, me të dhënat konfidenciale, personale, të redaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale”*, duke plotësuar kështu një nga rekomandimet e GRECO.

Lidhur me rekomandimin *“v. i) Deklarimet e pasurive të deputetëve të jenë objekt i kontrolleve të plota më të shpeshta; dhe ii) Të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe institucioneve të tjera përgjegjëse”*, ishte plotësuar pjesërisht.

Në vlerësimin e pikës “v. i) *Deklarimet e pasurive të deputetëve të jenë objekt i kontrolleve të plota më të shpeshta*”, GRECO theksoi se nuk mund të arrinte në një përfundim që kjo çështje është shqyrtuar qoftë edhe vetëm pjesërisht, për sa kohë ndryshimet ligjore janë vetëm në formë drafti.

Në vlerësimin e pikës “v. ii) *Të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe institucioneve të tjera përgjegjëse*”, GRECO arriti në përfundimin se kjo pjesë e rekomandimit ishte përmbushur, duke e konsideruar si një zhvillim pozitiv nënshkrimin e protokolleve të bashkëpunimit midis ILDKPKI dhe një numri institucionesh përfshirë autoritetet tatimore, të cilat kanë çuar në një numër domethënës referimesh penale dhe masash administrative të marra, jo vetëm në lidhje me deputetët, por edhe për zyrtarë të tjerë publikë, për shkelje të detyrimit të tyre ligjor për deklarim të pasurisë.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë propozoi dhe mbështeti ndryshimet në kuadrin ligjor lidhur me mundësinë e ndryshimit të afatit kohor brenda të cilit deklaratat e interesave privatë të deputetëve duhet t'i nënshtrohen kontrollit. Kështu, me anë të ligjit nr. 42, datë 6.4.2017 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” në nenin 25/1 u parashikua se: “Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë kryhet: a) çdo 2 vjet për Presidentin e Republikës, deputetët....”* duke plotësuar kështu një nga rekomandimet e GRECO.


6. TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

ILDKPKI ka vazhduar edhe përgjatë vitit raportues të ndjekë një politikë të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, duke forcuar më tej urat e bashkëpunimit midis tyre dhe institucionit, gjithmonë në respektim të kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjatë marrjes dhe trajtimit të kërkesave për informim.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka vijuar të trajtojë të gjitha kërkesat e individëve apo mediave, lidhur me publikimin e deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, brenda afatit 10 ditor, pavarësisht fluksit të kërkesave dhe procesit të përpunimit manual për redaktimin e të dhënave personale, duke rritur kështu transparencën institucionale. Fakti që nuk kemi pasur kontestime apo ankesa nga palët e interesuara, tregon për një punë korrekte dhe serioze.

Volumi gjithmonë e më shumë në rritje tregohet në mënyrë të qartë edhe nga të dhënat e publikimit të deklaratave të interesave privatë, ku ILDKPKI gjatë periudhës 2014 - 2017 ka publikuar rreth 30.772 deklarata me kërkesë, ndër të cilat vetëm për vitin 2017 janë publikuar përrreth 13.419 deklarata.

Deklaratat e Interesave Private të Publikuara ndër vite



	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Totali
■ Deklaratat e Interesave Private të Publikuara ndër vite	0	2100	6944	8309	13419	30772

7. PERFORMANCA FINANCIARE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale, për zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për vitin raportues si më poshtë vijon:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr. 130/2016, datë 15.12.2016, “Për Buxhetin e vitit 2017”, Udhëzimit nr. 8, datë 13.1.2017, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” i ndryshuar, i është akorduar një fond buxhetor prej 141.000.200 lekë, i cili përbëhet nga:

- Fondi i Pagave 101.000.820 lekë (zëri 600)
- Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15.000.880 lekë (zëri 601)
- Fondi për Shpenzime Operative: 20.000.260 lekë (zëri 602)
- Fondi për Investime: 3.000.000 lekë (zëri 231)
- Transferime korrente: 240.000 lekë (zëri 606)

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” i ndryshuar, për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë realizoi vlerën buxhetore prej 129,615,9/000 lekë ose 91.8% të fondit të planifikuar për vitin 2017.

ILDKPKI, referuar buxhetit të vitit 2017, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar”.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 69 punonjës, nga 70 punonjës të miratuar me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 48, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, të ndryshuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, vlerën 97.041.653 lekë, ose 95,31% e fondit të planifikuar për vitin 2017 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 12.925.326 lekë, ose 81,39%%, e planifikimit për periudhën respektive.

ILDKPKI, gjatë kësaj periudhe ka kryer procedurat e rekrutimit, në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për plotësimin e vendeve të reja të punës sipas kategorive përkatëse të miratuara, në rritje me 10 punonjës të numrit të përgjithshëm të punonjësve në kuadër të shtimit të kompetencave me miratimin e ligjit nr. 60/2016, për vendet vakante Inspektor dhe Ndihmës/Inspektor.

Për vitin 2017, në realizimin e shpenzimeve buxhetore, Inspektorati i Lartë është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave në harmonizimin e nevojave të ILDKPKI, me burimet financiare në dispozicion, në funksion të përmirësimit tërësor të infrastrukturës institucionale, të rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave privatë dhe me zbatimin e politikave buxhetore, përmes përdorimit ekonomik dhe eficient të burimeve financiare.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontroll në përputhje me legjislacionin përkatës, me transparencë, efektivitet, efijencë dhe ekonomi, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave janë krijuar sisteme kontrolli të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim, duke synuar përmbushjen optimale dhe realizimin e objektivave të përcaktuar.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2017, në realizimin e shpenzimeve operative, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- ✓ Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare, në funksion të një veprimtarie normale institucionale, të cilat për periudhën e raportuar janë realizuar në masën 100% të fondit të planifikuar vjetor.
- ✓ Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional.

- ✓ Forcimin e mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesave privatë të zyrtarëve brenda dhe jashtë vendit.
- ✓ Rritjes së numrit të hetimeve administrative, të filluara kryesisht nga denoncimet e qytetarëve, shoqërisë civile, medias, biznesit etj.
- ✓ Forcimit të vazhdueshëm të bashkëpunimit të ILDKPKI, me organet e auditimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse, për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.
- ✓ Zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës teknologji - informacion.

Gjatë këtij viti, shpenzimet buxhetore të domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara krahas prokurimit me tender, janë realizuar dhe me blerje të vogël, sipas procedurës elektronike dhe janë lidhur kontrata në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe. Shpenzimet e domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara gjejnë realizim, sipas nevojave konkrete të institucionit.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI për vitin 2017, kanë ardhur kryesisht nga arkëtimi i sanksioneve administrative me gjobë të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe ekzekutimit të detyrueshëm nga Zyrat e Përmbartimit, për një vlerë totale prej **43.652.964 lekë**. Këto të ardhura, në zbatim të VKM nr. 432, dt. 28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit, në masën 100%.

ILDKPKI, në vijim do të vazhdojë të ndjekë një politikë menaxhuese efektive, të fondeve buxhetore të akorduara, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore, duke mundësuar zbatimin efektiv të objektivave të institucionit, në funksion të një vendimmarrjeje transparente në kontrollin e deklarimit të pasurive, ligjshmërinë e burimeve të krijimit, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët dhe personat e lidhur me ta, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave të zyrtarit, në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe arritjen e standarteve më të mira bashkëkohore.

8. PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE

Në vijimësi të punës dhe angazhimit të marrë, lidhur me rritjen e performancës institucionale, gjatë vitit të katërt të ushtrimit të mandatit si Inspektor i Përgjithshëm, më lejoni që në vija të përgjithshme të parashtroj arritjet me theks të veçantë në:

- Marrjen e të gjitha masave institucionale me qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vettingut), duke garantuar procesin e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të deklaratave të pasurisë për **794 subjekte të rivlerësimit**.
- Fillimin dhe ndjekjen e procesit të verifikimit të të dhënave të pasqyruara në deklaratat e pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, në dokumentat justifikues e shoqërues lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë, nëpërmjet kërkimit dhe marrjes së të dhënave nga personat

juridikë publikë dhe privatë **për më shumë se 3.000 persona** (subjekte të rivlerësimit dhe persona të lidhur).

- Administrimin dhe përpunimin e një korrespondencë të gjerë më shumë se **1 milion e 200 mijë faqe** përgjigjesh të ardhura nga personat juridikë publikë dhe privatë, përfshirë dhe dokumentacionin e dorëzuar nga vetë subjektet e rivlerësimit, me një volum të konsiderueshëm informacioni, i përpunuar tërësisht në mënyrë manuale dhe i pasqyruar nëpër aktet e kontrollit të subjekteve të rivlerësimit.
- Përparësinë e procesit të kontrollit të subjekteve të rivlerësimit, në përmbushje të detyrimeve ligjore, duke hartuar listën e subjekteve prioritare, në të cilën u përfshinë funksionarët më të lartë të sistemit të drejtësisë, duke filluar nga Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kandidatët nga radhët e gjyqësorit/prokurorisë për KLGJ dhe KLP.
- Vendosja e marrëdhënieve institucionale me organet e rivlerësimit dhe me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) me qëllim garantimin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit, duke dërguar pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës nëntor - dhjetor 2017, dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara sipas konkluzioneve të kërkuara nga neni 33, të ligjit nr. 84/2016 **për 67 subjekte të procesit të rivlerësimit**, duke filluar nga Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kandidatët nga radhët e gjyqësorit/prokurorisë për KLGJ dhe KLP.
- Zbatimin me rigorozitet të skemës së kontrollit të plotë, ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, **për 1.335 subjekte deklaruese**.
- Ndëshkimin e të gjithë shkelësve të kuadrit ligjor, duke aplikuar **436 masa administrative ‘gjobë’** dhe depozituar **32 referime penale** pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke kërkuar në çdo rast dhe marrjen e masave disiplinore nga institucionet ku zyrtarët shkelës të ligjit, kryejnë funksionet publike.
- Marrjen e të gjitha masave ligjore dhe institucionale, lidhur me zbatimin e ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*. Në këtë kuadër, u hartuan dhe miratuan brenda afateve ligjore, aktet nënligjore në kompetencë të Inspektorit të Përgjithshëm; identifikimi dhe ngritja e njësive përgjegjëse në sektorin publik dhe privat; hartimi i Regjistrit Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike, ku janë ngritur dhe funksionojnë **163 njësi përgjegjëse**, si dhe Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Sektorin Privat, ku janë ngritur dhe funksionojnë **446 njësi përgjegjëse**; aplikimin e masave administrative me gjobë për rreth **140 drejtues organizatash** të cilat mbartnin detyrimin për ngritjen dhe raportimin e njësive përgjegjëse, por që nuk e përmbushën këtë detyrim brenda afateve ligjore; zhvillimi i fushave ndërgjegjësuere dhe sesioneve trajnuese lidhur me njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor nga subjektet e këtij ligji.
- Në zbatim të nenit 4/2 dhe nenit 34, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa*

nëpunësve publikë”, i ndryshuar, i cili i hapi rrugën mundësisë së plotësimit dhe depozitimit të deklaratave elektronikisht, Inspektorati i Lartë filloi procesin e ngritjes së sistemit elektronik, të deklarimit të interesave privatë, i cili do të mundësojë rritjen e efikasitetit në plotësimin, administrimin, kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, si dhe publikimin e të dhënave në deklaratat e interesave privatë për konsultim nga publiku, media, shoqëria civile apo çdo palë tjetër e interesuar. Në këtë kuadër, gjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë bashkëpunoi ngushtësisht me USAID dhe Këshillin e Evropës duke siguruar mbështetjen e tyre financiare lidhur me zhvillimin e programit të sistemit dhe pajisjet për funksionimin e tij.

- Ndjekjen e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, ku të gjitha kërkesat e paraqitura për publikim të deklaratave të interesave privatë, janë trajtuar në përputhje me afatet ligjore, gjë që ka rezultuar në **publikimin e rreth 13.419 deklaratave të interesave privatë, gjatë vitit 2017.**

9. PRIORITET PËR VITIN 2018

- Ruajtja dhe forcimi i pavarësisë dhe integritetit institucional, duke qenë kështu garant i paanshmërisë dhe objektivitetit të Inspektoratit të Lartë.
- Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit, duke garantuar vijueshmërinë e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting-un) në hartimin dhe dërgimin pranë institucioneve të rivlerësimit dhe ONM, të dokumentacionit të plotë, së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara sipas konkluzioneve të kërkuara nga neni 33 i ligjit nr. 84/2016.
- Ndjekja dhe zbatimi i skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuar nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin...*”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave...*”, i ndryshuar.
- Zbatimi dhe monitorimi i ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, në drejtim të forcimit të kapaciteteve të njësive përgjegjëse pranë organizatave të sektorit publik dhe privat, si dhe realizimin, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të fushatës ndërgjegjësuere.
- Forcimi i marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklarimit, me qëllim rritjen e eficiencës dhe cilësisë së punës të Inspektoratit të Lartë, duke përfunduar ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit e publikimit të deklaratave të interesave privatë.

- Vazhdimi i ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimi i mëtejshëm i urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave privatë.

ANEKSI NR. 1

Në kuadër të zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, për çështjet e përfshira në planin e veprimit, për të cilat është kërkuar raportim në një aneks të veçantë të Raportit Vjetor, Inspektorati i Lartë parashtron sa më poshtë vijon:

A- Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ekzekutivi gjatë periudhës së raportimit

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të kuadrit ligjor, ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” ka në kompetencë të tij sanksionimin me anë të masave administrative “gjobë” për shkelje të konstatuara të dispozitave ligjore nga subjektet deklaruese apo njësitë përgjegjëse.

Inspektorati i Lartë, për të gjitha masat administrative “gjobë” ka ndjekur rrugët ligjore për të garantuar vënien e tyre në ekzekutim vullnetar ose të detyrueshëm nga ana e subjekteve të sanksionuar.

B- Pasqyrat financiare, audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm, statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale, plani i veprimit të institucionit, raport ose informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të rritjes së kapaciteteve njerëzore në funksion të misionit të institucionit

- Audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm

Në strukturën e ILDKPKI nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2017, ILDKPKI u përfshi në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përfundim të të cilit nuk janë konstatuar shkelje lidhur me performancën institucionale.

- Plani i veprimit të institucionit

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, mbështet planin e veprimit të institucionit në zbatim të skemës së kontrollit deklaratave të interesave privatë, përcaktuar nga neni 25/1, i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve

publike”, i ndryshuar, duke kryer kontrollet e deklaratave të interesave privatë të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9367/2005 i ndryshuar.

Gjithashtu, në kuadër të reformës në drejtësi, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” një pjesë e konsiderueshme e kapaciteteve institucionale do të vazhdojnë të jenë të angazhuar në verifikimin dhe hetimin e deklaratave të pasurive të subjekteve të përfshirë në procesin e vlerësimit kalimtar (vettingut).

Në objektivat institucionale të Inspektoratit të Lartë, për vitin në vijim janë përfshirë në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” forcimi i kapaciteteve të njësive përgjegjëse pranë organizatave të sektorit publik dhe privat, si dhe realizimi në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të fushatës ndërgjegjësuese.

- Pasqyrat financiare

TABELA E BUXHETI DHE REALIZIMI

Llog. Ek	Peshkrimi	Plan Buxheti vjetor 2017 I Rrshkuar	Plan Buxheti I realizuar VITI 2017	Realizimi % si 8- Mujor
600	Fond Page	101,820.0	97,042.0	95.31%
601	Kontrib. Sig. Shoq. & Shëndetësore	15,880.0	12,925.0	81.39%
602	Shpenzime operative	20,260.0	16,436.5	81.13%
606	Transferime per financime të tjera	240.0	240.0	100.00%
231	Investime	3,000.0	2,972.4	99.08%
	Totali	141,200	129,615.9	91.80%

- Statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave gjatë vitit raportues ka aplikuar **436 sanksione** administrative me gjobë për mosdeklarim të interesave privatë, konfliktit të interesit, si dhe për shkelje të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Nga këto janë ankimuar pranë organeve gjyqësore vetëm **117 vendime**, prej të cilave deri në momentin e raportimit, gjykata ka vendosur në mbështetje të vendimeve të marra nga ILDKPKI **për 111 vendime**, duke shfuqizuar vetëm një numër të pakonsiderueshëm **vendimesh** me sanksion gjobë.

Njëkohësisht, Inspektorati i Lartë ka marrë masa nëpërmjet organeve përmbarimore për vënien në ekzekutim të vendimeve lidhur me sanksionet administrative me gjobë, ku për vitin raportues rezulton të jenë vënë në ekzekutim **259 vendime**, ndërsa në **157 raste** shlyerja e detyrimit është bërë në mënyrë vullnetare nga subjektet e sanksionuara.

Inspektorati i Lartë, vijon ndjekjen e ekzekutimit të pjesës tjetër të vendimeve pranë organeve përmbarimore, si dhe njëkohësisht ndjekjen e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ, për çështje të ankimuar.

Në lidhje më rastet e referuara gjatë vitit raportues pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të

Parave, në momentin e raportimit nuk disponohet informacion i dërguar nga strukturat përkatëse.

- Informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të rritjes së kapaciteteve njerëzore në funksion të misionit të institucionit

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka përmbushur detyrimet që burojnë nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe sipas Kodit të Punës për punonjësit mbështetës. Nëpërmjet Njësisë Përgjegjëse janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke respektuar parimet kryesore të këtij legjislacioni, si dhe janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë të punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre në përputhje me afatet ligjore brenda çdo 6 muaj.

C- Zbatimi i masave specifike të dalta nga rekomandimet e instrumentave ndërkombëtarë, ku Shqipëria është shtet anëtar dhe të raporteve të Komisionit Evropian.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, propozoi dhe mbështeti ndryshimet në kuadrin ligjor, lidhur me mundësinë deklarimit online të deklaratave të interesave privatë, si dhe publikimin e tyre nëpërmjet sistemit të ri. Kështu, me anë të ligjit nr. 42, datë 6.4.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” u parashikuar në nenin 34, pika 2, se “Deklaratat e interesave privatë janë dokumente zyrtare dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të Inspektoratit të Lartë, me të dhënat konfidenciale, personale, të redaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ngritja dhe funksionimi i një sistemi elektronik për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë në Shqipëri, ka ardhur si një kërkesë në përmbushje dhe zbatim të detyrimeve të marra nën Prioritetin 3 “Lufta kundër Korrupsionit”, si pjesë e udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe për integrimin evropian të vendit, si dhe në dritën e rekomandimeve të shumta të instrumenteve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë (GRECO, ACFA, Dr. Tusseau).

Konkretisht, GRECO në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë, që trajton “Parandalimin e korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët”, si dhe Raportin Për Vlerësimin e Përputhshmërisë për Shqipërinë ka rekomanduar krijimin e një mjeti të tillë deklarimi që do të mundësonte vënien në dispozicion të publikut, të deklaratave të 140 deputetëve, në një faqe elektronike zyrtare, pa vonesa të mëtejshme duke i kushtuar vëmendjen e duhur privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe personave të lidhur me ta.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë me miratimin e ndryshimeve ligjore është përfshirë në zbatimin e dy projekteve të rëndësishëm të USAID dhe Këshillit të Evropës, të cilët do të mbështesin financiarisht institucionin, për të mbuluar një pjesë të madhe të nevojave të

identifikuara për ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit online të deklarimit të interesave privatë.

Gjithashtu, në përputhje me rekomandimin e GRECO mbi rritjen e shpeshtësisë së kontrollit të deklaratave të interesave privatë për deputetët, Inspektorati i Lartë propozoi dhe mbështeti ndryshimet në kuadrin ligjor lidhur me mundësinë e ndryshimit të afatit kohor brenda të cilit deklaratat e interesave privatë të deputetëve duhet ti nënshtrohen kontrollit. Kështu, me anë të ligjit nr. 42, datë 6.4.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” në nenin 25/1 u parashikua se: “ Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë kryhet: a) çdo 2 vjet për Presidentin, deputetët....”*

Ju faleminderit !